



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 41, datë 8.2.2019

PËR

**LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN
E LARTË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 14, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikës 7, të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

URDHËROJ:

1. Znj. Dhurata Bozo, drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, të lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Elvin Gjevori të emërohet drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
3. Marrëdhëniet e punës për znj. Dhurata Bozo të përfundojnë, sipas kërkesës për dorëheqje, në datën 4.2.2019.
4. Marrëdhëniet e punës për z. Elvin Gjevori të fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 253/2
DATË 11.2. 2019

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË
ARSIMIT TË LARTË

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

